

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
Prill 2025

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	15.04.2025	Te nderuar! Ne portalin e Informimit te Ministrise se Mbrojtjes ka ardhur kerkesa per informacion lidhur me disa pyetje per rastet e përdorimit operacional të shërbimit satelitor nga Albania 1 dhe Albania 2 në menaxhimin e emergjencave civile etj. Lutemi vleresimin dhe bashkëpunimin tuaj per kthimin e përgjigjes. Me respekt, Do t'ju lutesha të më vinit në dispozicion informacionet si më poshtë: - Rastet e përdorimit operacional të shërbimit satelitor nga Albania 1 dhe Albania 2 në menaxhimin e emergjencave civile - Specifikoni llojet e emergjencave sipas llojit/vendit dhe datës - Numri i institucioneve që kanë kërkuar imazhet satelitore si dhe arsyet e përdorimit të imazheve - Sa punonjës të administratës arrijnë t'i lexojne imazhet satelitore? - Kur përfundon ky shërbim dhe a është në plan rinovimi i kontratës për një periudhë tjetër?	17.04.2025	1. Rastet e përdorimit operacional të shërbimit satelitor nga Albania 1 dhe Albania 2 në menaxhimin e emergjencave civile Në përputhje me kërkesat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), është realizuar analizimi i imazheve satelitore për të identifikuar dhe vlerësuar zonat e prekura nga zjarret. Hartat tematike të zonave të prekura nga zjarri janë krijuar duke përdorur Inteligjencën Artificiale (IA) dhe metodën Change Detection, që identifikon dhe krahason ndryshimet midis periudhës para dhe pas zjarrit. Këto harta ofrojnë informacion të detajuar dhe të saktë, të cilat janë të rëndësishme për menaxhimin e emergjencave, planifikimin e rimëkëmbjes dhe vendimmarrjen	E plote	Nuk ka

				strategjike. Procesi i krijimit të hartave ka përfshirë analizimin e të dhënave satelitore dhe integrimin e tyre me shtresa të ndryshme për të përfaqësuar aspekte specifike të ndikimit të zjarreve. Për të siguruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse, janë përfshirë shtresat e mëposhtme: • Ndërtesa: Identifikimi i strukturave të prekura nga zjarri, duke përfshirë ato të dëmtuara dhe të padëmtuara. • Rugë: Vlerësimi i infrastrukturës rrugore dhe ndërlidhjes së saj me zonat e prekura. • Zonat e prekura nga zjarri • Mbulesa e tokës: Një analizë detajuar e kategorive të mbulesës së tokës, duke përfshirë: - o Sipërfaqe pyjore - o Sipërfaqe me bimësi të dendur, - o Sipërfaqe me bimësi të ulët, - o Sipërfaqe pa bimësi, - o Sipërfaqe ranore(nëse ka), - o Sipërfaqe ujore.	
--	--	--	--	---	--

			2. Specifikoni llojet e emergjencave sipas llojit/vendit dhe datës Deri me tani rastet e përdorimit operacional të shërbimit satelitor nga Albania 1 dhe Albania 2 në menaxhimin e emergjencave civile janë: 1. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Dropull, Korrik 2024 2. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Finiq, Korrik 2024 3. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Delvinë, Korrik 2024 4. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Stanet – Lazarat, Korrik 2024 5. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Veliqot – Luzat, Gusht 2024 6. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Tepelenë, Gusht 2024 7. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Shëngjin, Gusht 2024 8. Harta tematike e zonave	
--	--	--	---	--

			të prekura nga zjarri në Gjadër, Gusht 2024 9. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Malësinë e Madhe, Gusht 2024 10. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Pishë-Poro, Fier, Tetor 2023 11. Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Peshtan, Fier, Korrik 2023 12. Web-map “Ndërtesat dhe infrastruktura rrugore brenda zonave me rrezik të lartë përmbajtje” për basenin Drin-Bunë 3. Institucione t shtetërore që ju janë shpërndarë produkte të përfutuara nga përpunimi i imazheve satelitore sipas kërkesave 1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile 2. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 3. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore 4. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 5. Agjencia e	
--	--	--	--	--

			Menaxhimit të Burimeve Ujore 6. Ministria e Mjedisit dhe Turizmit 7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit 8. Agjencia Kombëtare e Pyjeve 9. Agjencia Kombëtare e Bregdetit 10. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile 11. Instituti i Statistikave 12. Inspektoriat i Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit 13. Bashkitë 14. Gjykata dhe prokurori të rretheve të ndryshme. 4. Sa punonjës të administratës arrijnë t'i lexojne imazhet satelitore? Nisur nga interesi dhe kërkesat gjithnjë në rritje për përdorimin e informacionit të gjeohapësinor gjatë periudhës maj - nëntor 2024, ASIG ka mundësuar trajnimin e stafit teknik të 16 Institucioneve Publike duke realizuar 9 seanca trajnimi të dedikuara me pjesëmarrjen e 65 përfaqësuesve si mëposhtë:	
--	--	--	--	--

				1. Hekurudha Shqiptare në datën 03.05.2024 me pjesëmarrjen e 3 përfaqësuesve; 2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) në datën 10.05.2024 me pjesëmarrjen e 3 përfaqësuesve; 3. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) në datën 10.05.2024 me pjesëmarrjen e 5 përfaqësuesve; 4. Autoriteti Portual Durrës në datën 10.05.2024 me pjesëmarrjen e 3 përfaqësuesve; 5. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) në datën 10.05.2024 me pjesëmarrjen e 2 përfaqësuesve; 6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) në datën 16.05.2024 me pjesëmarrjen e 1 përfaqësuesi; 7. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) në datën 16.05.2024 me pjesëmarrjen e 2 përfaqësuesve; 8. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) në datën 16.05.2024 me pjesëmarrjen e 2 përfaqësuesve; 9. Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP)		
--	--	--	--	--	--	--

				në datën 16.05.2024 me pjesëmarrjen e 3 përfaqësuesve; 10. Agjencia Kombëtare Ujësjiellës- Kanalizimeve (AKUK) në datën 24.05.2024 me pjesëmarrjen e 5 përfaqësuesve; 11. Inspektoriat i Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT) në datën 31.05.2024 me pjesëmarrjen e 4 përfaqësuesve; 12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) - Drejtoria Vendore Kukës në datën 24.06.2024 me pjesëmarrjen e 5 përfaqësuesve; 13. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) - Zyra Vendore Tropojë në datën 24.06.2024 me pjesëmarrjen e 1 përfaqësuesi; 14. Agjencia e Trajtimin të Pronave (ATP) në datën 27.09.2024 me pjesëmarrjen e 9 përfaqësuesve; 15. Agjencia Kombëtare Ujësjiellës- Kanalizimeve (AKUK) dhe Shoqëritë Rajonale Ujësjiellës – Kanalizime në datën 25.10.2024 me pjesëmarrjen e	
--	--	--	--	---	--

				12 përfaqësuesve; 16. Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore (AMVV) në datën 14.11.2024 me pjesëmarrjen e 5 përfaqësuesve. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) zbatoi një sërë sesionesh trajnimi gjithëpërfshirëse me fokus informacionin gjeohapësinor në 57 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV), me pjesëmarrjen e 534 nëpunësve të Administratës Publike. Këto sesione trajnimi kanë synuar në rritjen e aftësive teknike të punonjësve të Administratës Publike, duke i pajisur ata me kompetencat e nevojshme për të përdorur në mënyrë efektive informacionin të përftuar nga Shërbimet Satelitore. Temat e trajnimeve kanë qenë: • Implementimi i projektit ‘Monitorimi i Territorit me Teknologji të Avancuar’; • Menaxhimi dhe analizimi i	
--	--	--	--	--	--

				imazheve satelitore; • Përdorimi i imazheve satelitore për çështje të veçanta; • Produktet dhe shërbimet që ofrohen; • Përfshirja e Autoriteteve Publike Përgjegjëse; Është dhënë asistencë teknike për përdorimin ArcGIS Online institucionit AKM (Agjencia Kombëtare e Mjedisit), MBZHR (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural). 5. Kur përfundon ky shërbim dhe a është në plan rinovimi i kontratës për një periudhë tjetër? Bazuar në kontratë Kontraktori do t'i ofrojë Autoritetit Kontraktor përdorimin ekskluziv dhe shërbimin operativ satelitor për të gjithë periudhën 3-vjeçare në Republikën e Shqipërisë, e cila përfshin: territorin tokësor, liqenet, ujërat e brendshme, ujrat territoriale dhe zona ekskluzive ekonomike e Republikës së Shqipërisë e cila përfundon me	
--	--	--	--	---	--

				datë 29.09.2025 Në lidhje me vazhdimësinë së projektit shërbime satelitore, mendojme se vazhdimësia e kësaj kontrate pas përfundimit të 3-vjeçarit, është shumë e rëndësishme në monitorimin e territorit si dhe krijimi në periudhe kohore të ndryshme i bazës të dhënash gjeoinformacioni për institucionet shqipëtare në realizimin e projekteve dhe objektivave të tyre në funksion të mirëqeverisëjes në përmirësimit e cilësë së shërbimeve dhe rritjes së kapaciteteve në fushën e përdorimit të produkteve që përftohen nga analizimi i imazheve satelitore.		
--	--	--	--	--	--	--